

Garë ndërkombëtare KENGUR 16.03.2017**Klasa e 6 dhe 7 -Kategorija Benjamin**

Koha në disponim është 1h e 15 min.

Për përgjigje jo të saktë të pyetjes minusohet një e katërta e numrit të pikëve me të cilat vlerësohet kjo pyetje. Për të shmangur rezultat të përgjithshëm negativ në fund shtohen 30 pikë, kështu që sasia maksimale e pikëve të fituara është 150. Gjatë punës nuk lejohen kalkulatorët


Cdo detyrë me numër rendor nga 1 deri 10 vlerësohet me 3 pikë






1. Katër letra janë radhitur në një rresht: $\boxed{2} \boxed{0} \boxed{1} \boxed{7}$. Është e lejuar që vetëm dy letra të mund t'i ndërrojnë vendet. Cili rresht me letra nuk mund të fitohet?

- (A) $\boxed{2} \boxed{7} \boxed{1} \boxed{0}$ (B) $\boxed{0} \boxed{1} \boxed{2} \boxed{7}$ (C) $\boxed{1} \boxed{0} \boxed{2} \boxed{7}$ (D) $\boxed{0} \boxed{2} \boxed{1} \boxed{7}$ (E) $\boxed{2} \boxed{0} \boxed{7} \boxed{1}$

2. Miza ka 6 këmbë, ndërsa merimanga ka 8 këmbë. Së bashku, 3 miza dhe 2 merimanga kanë aq këmbë sa kanë së bashku këmbë 9 pula dhe disa mace. Sa është numri i maceve? .

- (A) 2 mace (B) 3 mace (C) 4 mace (D) 5 mace (E) 6 mace

3. Ana ka 4 figura me këtë formë . Cilën prej figurave të mëposhtme Ana nuk mund ta formojë me ndihmën e 4 figurave të dhëna?


- (A)  (B)  (C)  (D)  (E) 

4. Miri di që $1111 \times 1111 = 1234321$. Sa është 1111×2222 ?






- (A) 3456543 (B) 2345432 (C) 2234322
(D) 2468642 (E) 4321234

5. Në një planet ka 10 ishuj dhe 12 ura, vizatimi djathtas. Në këtë moment të gjitha urat janë të hapura për qarkullim. Cili është numri më i vogël i urave që duhet të mbyllen që të ndërpritet qarkullimi midis ishujve A dhe B.

- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5




6. Rinocerontët Beni, Kate dhe Mira dolën për shëtitje. Beni ecën i pari, Katja në mes, ndërsa Mira ecën e fundit. Beni peshon 500 kg më shumë se Katja. Katja peshon 1000 kg më pak se Mira. Cila prej figurave të mëposhtme e tregon Benin, Katen dhe Mirën të renditur sipas rradhës së shëtitjes?

- (A)  (B)  (C) 
(D)  (E) 

7. Në çdo faqe të një kubi të veçantë është shkruar nga nga një numër. Shumat e numrave të shkruar në faqet e kundërta të kubit janë të barabarta. Pesë prej numrave të shkruar janë 5, 6, 9, 11 dhe 14. Cili është numri i gjashtë?

- (A) 4 (B) 7 (C) 8 (D) 13 (E) 15

8. Në vizatimin djathtas është dhënë një drejtkëndësh. Luli do që t'i ngjyrosë katrorët në drejtkëndësh kështu që një e treta e të gjithë katrorëve të jenë blu dhe gjysma e të gjithë katrorëve të jenë të verdhë. Katrorët e mbetur Luli do që t'i ngjyrosë me ngjyrë të kuqe. Sa katrorë do të ngjyrosë Luli me ngjyrë të kuqe?



- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5

9. Luli dhe Miri marrin pjesë në garën "Kengur". Për të njëjtën kohë Luli zgjidh 2 ushtrime, ndërsa Miri zgjidh tre ushtrime. Të dy së bashku zgjidhën 30 ushtrime. Sa ushtrime më shumë zgjidhi Miri sesa Luli?

- (A) 5 (B) 6 (C) 7 (D) 8 (E) 9


10. Tani palosi një fletë letre dhe duke përdorur një gjelperë, mbi fletën e letrës së palosur, bëri një vrimë. Më pas e shpalosi letrën dhe ajo dukej siç është treguar në vizatimin djathtas. Cili prej vizatimeve të dhëna i paraqet vijat sipas të cilave Tani e palosi fletën e letrës?



- (A) (B) (C) (D) (E)

Cdo detyrë me numër rendor nga 11 deri 20 vlerësohet me 4 pikë


11. Një sallon për mobilje moderne shet kolltuk tre vendesh, kolltuk dy vendesh dhe kolltuk një vendësh të punuara me të njëjtin modul, siç është treguar në vizatim. Duke përfshirë dhe mbajtëset e duarve, gjerësia e kolltikut tre vendesh është 220 cm, ndërsa gjerësia e kolltikut dy vendesh është 160 cm.



Sa e gjerë është e kolltikut një vendësh?

- (A) 60 cm (B) 80 cm (C) 90 cm (D) 100 cm (E) 120 cm

12. Pesë çelësa hapin pesë drynj. Numri i secilit prej çelësave i korespondon shkronjave të drynit të cilin e çel. (shiko vizatimin). Cili numër është shkruar në çelësin e fundit?



- (A) 382 (B) 282 (C) 284
(D) 823 (E) 824


13. Miri në një radhë i shkroi të gjithë numrat nga 1 deri 20 dhe fitoi numrin 31-shifror

1234567891011121314151617181920.

Më pas fshiu 24 prej 31 shifrave të shkruar në mënyrë të tillë që numri që ngeli numri më i madh i mundshëm. Cilin numër fitoi Miri?


- (A) 9671819 (B) 9567892 (C) 9781920 (D) 9912345 (E) 9818192

14. Luli do që ta vendosë në kuti konstruksionin e dhënë në vizatimin djathtas. Cila prej kutive të mëposhtme është më e vogla të cilën mund ta përdorë?



- (A) $3 \times 3 \times 4$ (B) $3 \times 5 \times 5$ (C) $3 \times 4 \times 5$
(D) $4 \times 4 \times 4$ (E) $4 \times 4 \times 5$

15. Në tabelën 2×2 janë shkruar numrat a, b, c, d , dhe më pas janë mbledhur numrat e shkruar në secilën radhë dhe secilën kolonë (shiko vizatimin djathtas). Cili pohim është i saktë?




- (A) a është e barabartë me d (B) b është e barabartë me c (C) a është më i madh se d
(D) a është më e vogël se d (E) c është më i madh se b

16. Miri ishte në mal 5 ditë. Ai u nis të hënën dhe u kthye të premtën. Çdo ditë Miri ecte 2 km më shumë se ditën e mëparshme. Gjatë ecjes në mal Miri përshkoi gjithsej 70 km. Sa kilometra përshkoi Miri të enjten?


- (A) 12 km (B) 13 km (C) 14 km (D) 15 km (E) 16 km

17. Në vizatimin djathtas në trekëndëshin e parë është vizatuar një kengur. Vijat e ndërprera të vizatimit sillen (reflektojnë) si pasqyra. Dy pasqyrimet e para janë treguar në vizatim. Si duket vizatimi në trekëndëshin me ngjyrë gri?




- (A) (B) (C) (D) (E)


18. Luli ka një shumë të caktuar parash dhe 3 shkopinj magjike të cilët mund t'i përdorë vetëm një herë.



ky shkop magjik shton 1EUR.



ky shkop magjik zbrit 1EUR.




ky shkop magjik e shumëzon shumën e parave me 2.

Sipas cilës renditje Luli duhet t'i shfrytëzojë shkopinjtë magjike kështu që ai në fund të fitojë shumën më të madhe të mundshme të parave?

- (A) (B) (C) (D) (E)

19. Miri ka tre katrorë. I pari ka brinjë me gjatësi 2 cm. I dyti ka brinjë me gjatësi 4 cm dhe kulm i cili gjendet në qendër të katrorit të parë. I fundit ka brinjë me gjatësi 6 cm dhe kulm që gjendet në qendër të katrorit të dytë, siç është treguar në vizatim. Sa është suprina e figurës së tillë të fituar?



- (A) 32 cm^2 (B) 51 cm^2 (C) 27 cm^2 (D) 16 cm^2 (E) 6 cm^2

20. Katër lojtarë shënuan gola në një garë hendbolli. Secili prej tyre shënoi numër të ndryshëm golash. Midis tyre Luli është ai që shënoi më pak gola. Tre lojtarët e tjerë shënuan gjithsej 20 gola. Cili është numri më i madh i golave që mund të shënojë Luli?


- (A) 2 (B) 3 (C) 4 (D) 5 (E) 6

Cdo detyrë me numër rendor nga 21 deri 30 vlerësohet me 5 pikë

21. Një kornizë përbëhet prej 2 kube ngjyrë gri dhe 1 kub i bardhë të ngjitur së bashku, siç është treguar në vizatimin djathtas. Cili kub mund të formohet me 9 korniza të tilla?

- (A) (B) (C) (D) (E)

22. Numrat 1, 2, 3, 4 dhe 5 duhet të shkruhen në pesë katrorët e vizatimit në mënyrë të tillë që të vlejë: Nëse numri është saktësisht nën një numër tjetër, atëherë ai duhet të jetë më i madh se numri mbi të. Nëse numri është nga e djathta e një numri, atëherë ai duhet të jetë më i madh se numri që është në të majtë të tij. Në sa mënyra mund të mbushet figura e vizatimit?



- (A) 3 (B) 4 (C) 5 (D) 6 (E) 8

23 Tetë kengurë janë radhitur në rresht si në vizatim.




Në një moment të dhënë, dy kengurë që janë njëri pranë tjetrit dhe të kthyer nga njëri-tjetri i ndërrojnë vendet duke u kapërcyer njëri me tjetrin. Kjo përsëritet deri sa janë të mundura të tilla kapërcime. Sa kapërcime janë bërë?

- (A) 2 (B) 10 (C) 12 (D) 13 (E) 16

24. Mira zgjodhi 5 numra të ndryshëm. Ajo ndonjërin prej numrave i shumëzoi me 2, ndërsa numrat e mbetur me 3 ku fitoi numër më të vogël të rezultateve të ndryshme. Cili është numri më i vogël i rezultateve të cilat ajo mund t'i fitojë?

- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5

25. Dyshemeja katrore në vizatimin djathtas është e mbuluar me pllaka trekëndëshe dhe katrore me ngjyrë gri dhe të bardha. Sa pllaka më së pakti duhet të zëvendësohen kështu që pamja e dyshemesë të jetë e njëjtë nga të gjitha drejtimet e shënuara ?



- (A) tre trekëndore, një katrore (B) një trekëndore, tre katrore
(C) dy trekëndore, dy katrore (D) tre trekëndore, tre katrore
(E) tre trekëndore, dy katrore


26. Në një çantë ka vetëm xhamli të kuqe dhe jeshile. Nëse nga kutija marrim pa parë 5 xhamli, atëherë më së pakti njëra prej tyre është e kuqe, ndërsa në qoftë se pa parë tërheqim 6 xhamli, atëherë më së pakti njëra prej tyre është jeshile. Sa xhamli më së shumti mund të ketë në kuti?

- (A) 11 (B) 10 (C) 9 (D) 8 (E) 7

27. Simona pëlqen numra çift, Maja pëlqen numra të plotpjestueshëm me 3, ndërsa Aleksandra pëlqen numra të plotpjestueshëm me 5. Në kuti ka 8 topa të vegjël në të cilët janë shkruar numra. Ato nga kutija marrin topa njëri pas tjetrit në të cilët janë shkruar numra që i pëlqejnë. U pa që Simona i mori topat me numra 32 dhe 52, Maja me 24, 33 dhe 45, Aleksandra me 20, 25 dhe 35. Sipas cilës renditje i morën topat vajzat?

- (A) Simona, Aleksandra, Maja (B) Aleksandra, Maja, Simona (C) Maja, Simona, Alaksandra
(D) Maja, Alaksandra, Simona (E) Aklaksandra, Simona, Maja

28. Miri do që të shkruaj nga një numër natyror në çdo fushë të vizatimit djathtas, por kështu që çdo numër mbi rrjeshtin e poshtëm të jetë shumë e dy numrave të shkruar në fushat saktësisht nën të. Cili është numri më i madh i numrave tek të cilët mund t'i shkruaj Miri?



- (A) 4 (B) 5 (C) 6 (D) 7 (E) 8

29. Julija ka katër lapsa ngjyrash prej druri me ngjyra të ndryshme dhe do të përdorë disa ose të gjitha lapsat me ngjyra që të vizatojë një hartë të një ishulli të ndarë në katër shtete, si në vizatimin djathtas. Në hartë dy shtete me kufi të përbashkët nuk lejohet të ngjyrosen me të njëjtën ngjyrë. Në sa mënyra mund të ngjyroset harta e ishullit?



- (A) 12 (B) 18 (C) 24 (D) 36 (E) 48

30. Në çdo fushë të një katrori 6×6 ka nga një llambë. Themë që dy llamba janë fqinje nëse ato ndodhen në fusha që kanë brinjë të njëjtë. Në fillim disa llamba ndriçojnë në çdo minutë, çdo llambë e cila ka dy llamba fqinje që ndriçojnë fillon të ndriçojë. Cili është numri minimal i llambave që duhet të ndriçojnë në fillim, që të jemi të sigurt që pas njëfarë kohe të gjitha llambat do të ndriçojnë?

- (A) 4 (B) 5 (C) 6 (D) 7 (E) 8